

FJALA E DEPUTETIT ERVIN SALIANJI

E ENJTE 8 SHTATOR 2022

U desh të fillonte sesioni i ri parlamentar dhe të fillonte punë ky Kuvend që qeveria të dilte me emergjencë në mëngjes për të treguar që është në punë. Si në çdo gjë tjetër, Kryeministri e trajton pozicionin që ka si Kryeministër i Republikës si një pozicion part-time, ashtu siç vendos aksione të përkohshme për gjithçka që ndodh në këtë vend dhe jo zbatim të ligjit në mënyrë permanente. Shqetësimi më i madh që kishte Kryeministri sot, në nisje të kësaj seance, ishin pishinat. Në fakt, duhet ta kishte këtë shqetësim, sepse jemi në rastin kur ka ndërhyrje brutale, të paligjshme. Në pishinat ku lahen dhe rrinë përfaqësues të qeverisë, përfshirë edhe Kryeministrin, pa diskutim që zhuli dhe llumi i korrupsionit, i lidhjeve me krimin dhe gjithçkaje tjetër, është i vështirë të lahet.

Ne nuk kemi qenë në asnjë moment te pishinat për qejf, por kemi qenë në mbrojtje të lirisë së medias nga një sulm brutal i bërë drejtpërdrejtë nga qeveria, dhe kjo u duk edhe sot për shkak të mllefrit personal që ka Edi Rama. Për shkak të mllefeve personale që ka Edi Rama, qytetarët shqiptarë e dinë se sa miliona euro kosto kanë për të paguar. Njëqind e kusur milionë euro ka nga çështja Becketi, miliona euro të tjera janë nga pallatet që i prishte për arsye politike dhe jepte miliona të tjera më pas. Nuk i harrojnë qytetarët këto, ashtu siç nuk harrojnë se si Edi Rama inspektonte punimet në resortin në pronësi të “Hysenbelliu Group”, por që kur nuk i pëlqen linja editoriale e këtij grupi mediatik, u turret me gjithçka mundet për të nxjerrë inatin personal të të gjitha investigimeve profesionale që media të pavarura bëjnë për t’u treguar qytetarëve se kush i qeveris, duke bërë hetime të thelluara thuajse në çdo sektor të qeverisjes.

Kur një kryeministër inspekton punimet dhe firmos vetë lejen, a është duke shpërdoruar detyrën? A ka mundësi të përgjigjet dikush me një logjikë normale? Minimalisht, a duhet kallëzuar Kryeministri për shpërdorim detyre dhe moskallëzim krimi? Nga ana tjetër, shikohet një trajtim i shtetit sikur të jetë një pronë personale. Para dy ditësh qeveria nxori një vendim ku ndryshonte tërësisht mënyrën se si do të konsiderohen ndërtimet e paligjshme. Nga Velipoja

deri në Ksamil i gjithë bregdeti është me ndërtime pa leje. Kryeministri u kujtua tani për 4 kate të ndërtuara pa leje në mes të Tiranës nga një prej njerëzve më të afërt të tij, që ka ndërtuar mijëra metra katrorë në Tiranë.

Sot dolën për një pallat tjetër 9-katësh. Ka shtet këtu apo nuk ka? A funksionojnë institucionet në këtë vend, apo nuk funksionojnë? Nëpër fshatra, në periferi, në qytete ku qytetarët ndërtojnë çati, bëjnë suva dhe oborre, apo në fshat ku ndërtojnë stalla, më përpara shkon taksidari, polici apo inspektori i INUK-ut për të marrë parane si ryshfet për ndërtimet pa leje, që të mos shkosh në burg, sesa shkon ustai në shtëpi, pavarësisht se kontraktohet. Më shtrenjtë shkon ryshfeti për qeverinë për të bërë suva, për të ndërtuar çati apo për të hapur dritare, në shtëpinë e çdo qytetari të këtij vendi, sesa kostojnë materiet e ndërtimit. Dhe në kushtet kur çdo qytetari të pamundur dhe pa lidhje me qeverinë i turren me gjithçka kanë dhe i tregojnë forcën brutale të shtetit, këtë nuk ua tregojnë oligarkëve, nuk ua tregojnë njerëzve që janë të lidhur drejtpërdrejt me interesat e qeverisë, por ua tregojnë njerëzve vetëm në mënyrë selektive, duke goditur ato ndërtime që ndërtohen në mënyrë të ligjshme.

Ndërkohë që japin miliona metra katrorë në bregdet, cep e më cep në vendet më të mira të Shqipërisë, në vend që atyre, që i konsiderojnë kundërshtarë politikë t'u japin statusin e investitorit strategjik, u çojnë ruspat dhe policët, për të treguar se në këtë vend nuk ka ligje, nuk ka institucione, nuk ka rregulla, ka vetëm një pasha apo një çifligar, i cili tenton ta trajtojë Shqipërinë sikur të jetë prona e tij personale, "për inate personale", ashtu siç shpesh e ka thënë ky Kryeministër. "Ç'është kjo more, dilni në foltore dhe shfrytëzoni foltoren e Kuvendit duke u marrë me emra personalë", ka thënë një herë e një kohë. Po ç'është ky Kryeministër? Opozita fjalën ka, dhe me të drejtë, me emra personalë do të merret, se nominalisht bëhet korrupsioni, nominalisht bëhen ndërtimet pa leje, nominalisht janë dhënë licencat për krime dhe për korrupsion. Kështu, i është bërë autostradë rruga krimit.

Ndërsa del sot dhe përmend emrat e pronarëve të medias, a thua se do të kompleksojë opozitën, që mbron dhe duhet të mbrojë edhe më shumë lirinë e medias në këtë vend, për shkak të turrjes që i bën qeveria, jo vetëm një biznesi, por çdo biznesi mediatik, kur shikon se linjën editoriale të tij nuk e nënshtron dot me mënyra të tjera të përfitimit drejtpërdrejt. Ja, kjo

është situata sot. Qeveria bën një vendim për të legalizuar, praktikisht, ndërtimet e oligarkëve, ndërtimet me 9 kate që u bëkan pa leje në mes të Tiranës, ngjitur me sheshin “Skënderbe”, ku shiten me miliona euro metrat katrorë. Qeveria nuk po i çon për ndjekje penale, por e tejkalon.

Nuk po u vendos gjoba, por po u thotë oligarkve: “Meqenëse i keni ndërtuar, paguani ca lekë për qeverinë, edhe zyrtarisht përveç se në forma të tjera dhe t’i gëzoni edhe këto”. Ndërkohë, kur bie fjala për pishinë, meqenëse e ka qejf, pishina duhet shembur, kurse katet pa leje në mes të Tiranës jo, katet pa leje në mes të liqenit apo rrotull liqenit, jo, ato duhen. Ne, siç kemi pasur një aksion të plotë për ndërtimet pa leje në 8 vjet në të gjithë Shqipërinë, ku kemi pasur një grup pune për të evidentuar çdo ndërtim të paligjshëm dhe për të çuar para përgjegjësisë penale, do të vazhdojmë me po të njëjtën mënyrë. Ne do ta monitorojmë situatën dhe nuk mund të kapërcehet zbatimi i ligjit, sepse i do qejfi Kryeministrit. Kjo është situata sot.

Nga ana tjetër, në mënyrë të përmbledhur, për shkak të kohës, dua të them që efektet e paketave të propozuara nga qeveria i keni në mediat britanike, pothuajse gjithë verën. Shikoni shifrat e Eurostati-t sesa janë kërkesat për azil nga qytetarët shqiptarë. Ngaqë ju nuk keni sy për të parë dhe veshë për t’i dëgjuar qytetarët, ata nuk ju shikojnë dot me sy, nuk jua shikojnë dot bojën, por tentojnë të ikin me çfarë të munden, duke hipur nëpër gomone, duke paguar miliona lekë, mijëra paund apo euro për të ikur nga ky vend, ndërkohë qeveria nuk ka asnjë reagim. Asnjë reagim nuk ka qeveria, pavarësisht se këtu ka reagime për të larguar drejtorin e policisë. Nuk ka reagime kur qytetarët vriten në mënyrë të strukturuar nga krimi i organizuar, si banda ushtarake me 3 persona, duke vrarë qytetarë ku t’u teket dhe si t’u teket. Kjo është ajo që bën qeveria sot.

Ndërkohë, në paketën e ndihmës nuk kishte për të rinjtë asnjë fjalë. “Prioritet i madh rinia, ka thënë”. Asnjë fjalë nuk u tha për rininë, jo ndihmë reale. Shikojeni pak paketën, në asnjë fjalë të vetme nuk përmenden të rinjtë, a thua se nuk ekzistojnë, ndihmë reale jo e jo. Po çfarë thoni: po rrisim pagat për administratën, se po vijnë zgjedhjet lokale dhe duhet të jepni ndonjë lek. Që nga viti 2017 nuk ka asnjë rritje page në administratë. Çfarë, 50 mijëlekëshi që po jepni tani është rritje, ndërkohë që çmimet kanë shkuar kacafiu kanë kaq kohë? Po u jepni 50 mijë lekë policëve, ndërkohë që duhet t’u jepni shumë më shumë para, sepse janë më të riskuarit sot,

janë njerëzit që punojnë realisht, edhe ata policët e thjeshtë që rregullojnë trafikun, edhe ata që përballen me krimin, sepse duke mos u dhënë para ju, u japin para kriminelët.

Në vend që kapë polici kriminelin, kap krimineli policin, edhe ecin të dy rrugëve. Të gjithë personat më të rrezikshëm në kërkim (do të kemi kohë në seancën tjetër të flasim për këtë), të gjithë personat me rrezikshmëri të lartë, që janë shpallur në kërkim nga SPAK-u, ju i keni pasur në fushatë elektorale dhe sot janë të gjithë në kërkim. Dhe patë, siç e panë gjithë shqiptarët, sesi vinin rrotull nëpër qytetet kryesore të këtij vendi, nëpër hotelet më me emër të këtij vendi, në mes të Tiranës, afër këtij institucioni, dhe i keni të gjithë në këtë nivel. Tani, dy fjalë për çështjen e energjisë dhe për biznesin, që po e godisni në mënyrë armiqësore, sikur ta keni kundërshtarin më të ashpër. Me rrogën minimale që po rrisni, do të rrisni edhe të ardhurat tuaja në qeveri, sepse ia keni ngarkuar biznesit.

I ngarkoni biznesit një pagë tjetër shtesë, qoftë për rritjen e pagës, qoftë për pagesën e sigurimeve shoqërore. Ndërkohë, pasi keni rritur energjinë, po them shkurt, meqenëse po më mbaron koha, sesi më shkruante një qytetar, i cili ka bashkëshorten dhe një fëmijë në shtëpi: “Duhet të rrish maksimumi dy orë me kondicioner ndezur në shtëpi, që të mos paguash pothuajse 400 mijë lekë faturën me rritjen që ka bërë qeveria”. Pse? 800 kWh pa TVSH, bëjnë 76 mijë lekë të vjetër, kush do të paguajë mbi 800 kWh, do t’i rritet 2- fish, 3-fish deri në 4,4 herë më shumë çmimi i energjisë, duke taksuar dhe duke renduar me pagesë shtesë gjithë shtresën e mesme, të gjithë personat që jetojnë në këtë vend me punë të ndershme, duke e bërë edhe këtë shtresë të shoqërisë, që të largohet nga ky vend. Faleminderit!